



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, parashtron këtë:

PROPOZIM

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2026, të miratojë këtë

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN - NDRYSHIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI –KKSB-së

Neni 1

Zëvendësimi dhe ndryshimi i anëtarëve të KKS-së

1.Me këtë Vendim, **zëvendësohen** – ndryshohen anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të caktuar me Vendimin për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi –KKSB Nr.15-020/04-13725 të datës 24.03.2026, si vijon:

1. Në numrin rendor 6, Afrim Mena nga komuniteti shqiptar zëvendësohet nga _____;

1.2 Në numrin rendor 13, Zyra për barazi gjinore plotësohet me **Linda Shahini**;

1.3 Në numrin rendor 19 Sead Aliu zëvendësohet nga **Burim Rrustemi**, Drejtor i ri i emëruar i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

1.4 Pas numrit rendor 22 shtohet numri rendor 23 dhe caktohet **Behar Aliu**, zyrtar komunal si Koordinator i KKSBB-së

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSBB-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSBB në Komunën e Lipjanit Nr.15-020/04-13725 të datës 24.03.2026.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Zëvendësimi i anëtarit në numrin rendor 6 nga komuniteti shqiptar bëhet përshkak se anëtari i deritanishëm nga komuniteti shqiptar Afrim Mena ka ndërruar jetë.

Për anëtare të KKSBB-së nga Zyra për Barazi Gjinore propozohet Linda Shahini, Zyrtare për Integritet Evropian pasi që nga shkuarja në pension e zyrtarit për barazi gjinore ende nuk është plotësuar kjo pozitë.

Zëvendësimi i anëtarit në numrin rendor 19 dhe caktimi i Burim Rustemit si anëtar i KKSBB-së bëhet për plotësimin e pozicionit të kërkuar si anëtar i KKSBB-së konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi pasi i njëjti është emëruar si Drejtori i ri i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Behar Aliu shtohet si Koordinator i takimeve të KKSBB-së pasi edhe me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi kërkohet që një zyrtar komunal të koordinojë takimet e KKSBB-së ashtu siq kërkohet nga Kryesuesi i KKSBB-së.

Nga arsyet e lartëcekura dhe në pajtim me dispozitat Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në Bashkësi dhe Statutit të Komunës Kryetari i Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi

1Nr. 020/04-33323

Lipjan, më 20.07.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

